

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

A N K E S Ë

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe

Për: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	633-25-7025-5-2-1
Nr i brendshëm	633-025-049-521

Sa i përket tenderit për: LOT 1 -NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE ZALLQ,

LOT 2 - NDERTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE VRELLË -PROJEKT DY VJEÇARE (633-025-049-521)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

TONI INGJINJERING SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llapushnik, Magjstralja, M9, Glllogoc

(Adresa)

Drenas (Glllogoc)

(Vendi)

13050

(Kodi postar)

+383 44 249 730

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Malush Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

toni.ingjinjering@hotmail.com

(Adresa elektronike)



15.06.2026

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues -Komuna e Istogut me date 01.08.2025 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: Lot 1 -Ndertimi i Ndriçimit Publik ne Zallq, Lot 2 - Ndertimi i Ndriçimit Publik ne Vrellë -Projekt dy vjeçar(633-025-049-521) Ne Komunen e Istugut , si në vijim:

- | Procedurë e hapur, **B05 i Publikuar me 01 gusht 2025**
- | Kontrate publike,
- | Punë, Vlerë e mesme
- | Vlera e parashikuar e kontratës 102,000.00 euro
- | Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve, ka qen me date 05.09.2025 ora:14:00,

Vendi: Zyra e Prokurimit

Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 05.09.2025 ora :14:00 ne platformën elektronike të prokurimit.

Me date 03.06.2026 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe te eliminuar.

Me 05.06.2026 Kemi bere Kerkese per Rishqyrtim

Me 08..06.2026 kemi pranuar Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim

Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde te tenderuesit te pa përgjegjshëm (te eliminuar) dhe Vendimin mbi refuzimin e kërkesës për Rishyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Hapja e tenderit është bere ne mënyre elektronike në vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar.
Nuk kemi vërejtje .

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues -Komuna e Istogut dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim kundër;

- **Njoftimit për eliminimin (Letrën standarde për tenderues te papërgjegjshëm-eleminuar) nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit.**
- **Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 03.06.2026**

Pretendojmë se, Komuna e Istogut përmes Komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

▪ Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, pika 1 dhe 3.
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, pika1.
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, pika 1,2 dhe 6
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie e Kontratave, pika 1, par 1.1 dhe 1.2
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 2 dhe 4
- Neni 60, Kriteret për Dhënie e Kontratës, pika 1, par 1.1
- Neni 72 të LPP-së, të Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, pika 1 dhe 2.
- Neni 40.12 Tenderuesi nuk do të **diskualifikohet** ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që **nuk është specifikuar në**

njoftimin e kontrates/dosjen e tenderit.

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejme do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 38, Sqarimi i Tenderëve.
- Neni 97, Shkeljet e rënda, pika 97.1 nen pika (d) dhe (o)

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- **Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore: Sa i përket Formulari Letrës standarde për tenderues te papërgjegjshëm - eliminuar.**

E kundërshtojmë në tersi vendimin e AK lidhur me letrën standarde për tenderues te eliminuar, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar, në interpretim të gabuara dhe jo të drejte të njoftimit për kontratë, dosjes së tenderit dhe sqarimeve shtese, si dhe duke shkel ligjin e prokurimit te nenit 40.12 qe thot: Neni 40.12 Tenderuesi nuk do të **diskualifikohet** ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që **nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.**

E kundërshtojmë në tersi vendimin dhe letrën standarde për eliminim të ofertës tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit, sepse është arbitrar, diskriminues, tendencioz, ka aferë korruptive tek komisioni per vlersim, është nxjerrë në shkelje të Ligjit, sepse, padrejtësisht na eliminon nga aktiviteti i mëtejme duke ber fshehje e dokumentacionit te ofruar dhe duke saju pretendime te rrejshme ne raport me ato qe jan kerku ne dosje te tenderit, edhe pse dokumentacini per keto pika është prezent ne dosjen e tenderit **jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulet.**

Në vijim do ti paraqesim faktet e rastit për secilën pikë, për të cilat AK ne arsyetim i konsideron si mungesë dhe, mi bazën e këtyre arsyeimeve na eliminon pa drejtësisht nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit.

SEPSE:

Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit me arsyetimin se ne bazë te nenit 59.

ARSETIM:

Kerkesa te Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka staf teknik tëmjftueshem dhe atë min. 10

punëtorë. Të jenë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë., Dëshmia 3. Lista e punetoreve duhet te dorëzohet e skanuar nga origjinali – e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Kontratat e punetoreve apo parakontratat per aktivitetin ne fjale. Certifikata SSHP

Pretendimi i AK per kerkesen 3 thot: Te kerkesa 3-jan kerkuar minmum 10 puntor te trajnuar per siguri dhe shendet ne punë.

O.E. ka deshmuar vetem 4 puntorë

Me keq ardhje e them ket sepse edhe ju si A.K. ju kini bashkangjit shpifjeve dhe mshefjes se dokumentacionit sikur qe e ka ba Ankuesi ju ka bashkangjit eksperti dhe tash edhe ju.Sipas kti pretendimi kan ba shpifje apo pretendime te rrejshme duke i fshehur dokumentacionin ,sepse jan te paraqitur mbi 10puntor te qertifikuar per siguri dhe shendet ne punë (prove materjale jan file 20 vlersimi I rriskut ku është raporti i vlersimit te rriskut dhe ne vazhdim jan edhe qertifikatat e 7 puntorve 1.Afrim FEJZA,2.Toni Krasniqi,3.Aldan Krasniqi,4.Qlirim Zogu,5.Habib Krasniqi, 6.Danush Krasniqi,7.Mirjeta Hoxha dhe ne file 24 stafi professional Teknik:1.Kujtim Krasniqi,2.Labinot Krasniqi,3.Qendrim Krasniqi,4.Shpend Zogu) Dmth ktu jan 11 puntor te qertifikuar per siguri dhe shendet ne punë.

Pretendimi pare bie si I pa bazuar apo I rrejshem nga Ankuesi, nga EKSPERTI edhe nga ju. (prov materiale dok. Nr.8)

Por per ju si AK edhe ma keq per arsye se mirë i keni vrejt heren e parë apo ne vlersimin e parë e tash po i fshehni kshtu qe ksaj vepre nga ana e juej nuk po i vjen erë e mirë.

Pretendimi i kesaj kerkesese (kerkeses 3) është i pa bazuar sepse jan edh 7 puntor te qertifikuar per siguri dhe shendet ne pun-provë materjale folderi nr. 20 i ngarkuar ne kompletim te dokumentacionit (shiko ne formularin e dorzimit te tenderit qe poju ngarkoi si provë materiale dhe po i nenvizoi dokumentet qe jan ngarku te cilat ju po e fshehni,qe fshehja e dokumenteve si ne ket rast është krim qe mundet te ket pasoja per AK).

-Kerkesa te Kapaciteti teknik dhe profesional: KERKESA 4. Pika b)

b) Një person I çertifikuar për sistemin e integruar të menaxhimit dhe sigurise se trafikut rrugor.

Pretendimi i AK per kerkesen 4. b) thot: Te kerkesa b) se OE ka deshmu vetem qertifikat për për siguri të trafikut rrugor

Ne kemi ofru staf profesinal edhe per ket pike.z. Qendrim Krasniqi qe është I qertifikuar me qertifikat tri vjeqare te komunikacionit rrugor,e cila perfaqson edhe sigurin dhe menagjimin e komunikacionit rrugor (shih dokumentin te stafi teknik dhe profesional me parakontrata) ka nr. 13 ne listen e stafit punues,qertifikata ka nr. te protokollit,qertifikata është tri vjeqare dhe puntoret me ket pergaditje jan edhe menagjues ne ket lami.(prova materiale 01.b) por e njejta gjindet ne dosje te tenderit.

Kshtu qe ky pretendim i pikes 4.b) është i pa bazuar -informacion shtesë lidhur me kerkesen e berë: Ak per ket kerkes nuk është ne dijeni qe shka ka kerku,por edhe OE qe ka ofru nji dokument prej nji kompanie privat ,ajo ska te baj fare me ket kerkesë,sepse ajo ka te bej vetem per strukturen e mbrendshme te kompanis termomontim,lexojeni mirë qka thot.

Prandaj edhe nji her po e themi se pretendimi pikes 4.b) është i pa bazuar.

Kerkesa te Kapaciteti teknik dhe profesional: KERKESA 4. Pika c)

c)Dy elektrikist te diplomuar me 5 vite, te çertifikuar për punime në lartësi dhe përdorimin e P.M.I për

mbrojtjen e rënjies nga lartësia., Dëshmia 4. Të deshmohet me kontratë pune aktive ose parakontrate per aktivitetin ne fjale,

Pretendimi i AK per kerkesen 4. c) thot: Te kerkesa 4c) jan kerku dy elektrikist te diplomuar me **përvojë punë së paku 5 (pesë) vite.**

- OE ka deshmue dy persona elektrikist instalues-qertifikat te ndriqimit rrugor 20.12.2023,qe nen kupton që nuk ka prevojë të mjaftueshme.

Pergjigja per piken 4c) AK apo komisini per vlërsim ne ket rast gjat vlërsimit shton fjali duke e anashkalu kerkesen qe është dhenë ne DT dhe duke ja shtu fjalin "**përvojë pune**" Se pari fjalia e cekur: **përvojë punë së paku 5 (pesë) vite** është e shtuar apo e komoflune sepse ne kerkesë nuk ekziston,shih kerkesen e dosjes se tenderit. Perveq ksaj nuk është cekë përvoj pune ,por nuk është cekë edhe kjo: "te ket 5 vite përvojë pune nga data e qertifikimit apo diplomimit" ,sepse dy personat ne fjal qe ne i kemi ne staf kan përvojë më shum se 5 vite (ket mundemi ta dokumentojm edhe me dok. Qe asht trusti se kur kan fillu,por perveq qertifikates si elektrikist kta jan edhe te diplomuar ne drejtimin e elektroteknikes kater vjeqar. (Deshmi materiale dok. Nr.01.1. trusti per dy tekniket)

Nëse i referohemi kërkesës së AK ne NJK dhe DT, është e qartë se AK pa drejtësisht na eliminon, ngase, të dëshmitë dokumentare **kërkon kritere qe nuk jan specifikuar ne njoftimin per kontratë duke shkel nenin 40.12 te ligjit te prokurimit**, prandaj është i pa pranueshëm arsyetimi i AK sa i përket kësaj pike duke e saju dhe pershtat vet komisioni ket kerkesë gjatë vlërsimit, për me tepër është tërësisht ne kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura me lartë.

-Kështu qe ky pretendim te pika 4.c) është i pa bazuar sepse perdor apo sajon kritere qe nuk jan specifikuar ne njoftimin per kontratë.

Dëshmia tjeter per stafin tekniket e lektroteknikes te diplomuar si teknik te elektros me kater vjeqar,per ket projekt jan te angazhuar ne kompani te cilet po i ceki:

1.Aldan Krasniqi -provë materjale diploma e elektroteknikes kater vjeqar dhe posedon qertifikat shtesë per instalime te ndriqimit rrugor dhe punet ne lartësi

2.Çlirim Zogu - provë materjale diploma e elektroteknikes kater vjeqar.

3.Sali Hoxha - provë materjale diploma e elektroteknikes kater vjeqar

4.Toni Krasniqi -provë materjale diploma e elektroteknikes kater vjeqar dhe posedon qertifikat shtesë per instalime te ndriqimit rrugor dhe punet ne lartësi.

5.Kujtim Krasniqi- provë materjale diploma e elektroinstalues dhe posedon qertifikat shtesë per instalime te ndriqimit rrugor dhe punet ne lartësi.(me parakontratë).

6.Labinot Krasniqi - provë materjale diploma e elektroteknikes kater vjeqar .(me parakontratë).

Kërkesa 5. Lista e mjeteve

dhe mekanizmi të ofruara nga Operatori Ekonomik a) 1 (një) Kamion kiper me kapacitet min. 10m³

Pretendimet lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional Ju si AK. e kini cek se :Te kërkesa 5-së pika 10 Lista e mjeteve dhe mekanizmit, konkretisht kamion kiper me kapacitet minimumi 10t.

Keni deklaruar se: OE Nuk ka deshmuar me librezë që posedon mjet te till.cp

SQARIM LIDHUR ME KET Pretendim: Ktu po shihet prap edhe te kjo pikë sepse ose nuk keni dasht qe ta gjeni ose keto dokumente nuk i keni shfletu fare sepse po nisna te gabimet gjat interpretimit ku thuno kerkesa 5 pika 10. Dmth te kerkesa 5 nuk kemi pikë te 10 por pikat jan me shkronja nga shkronja a) e deri te j).

-Prandaj po ju tregoi qe librezen e kti kamioni me kiper min. 10t. E kini te marrveshtja me kompani "M. SHALA FA" SH.P.K ne foldein nr.15. Dhe librezja e kti kamini ka **nr. Tabelav 01-523-EY** ,Kamion kiper dy dyer ngjyra e kalter e hirit tipi Scania (shiqo edhe ne dosje te marrveshtja me kompanin "M. SHALA FA" SH.P.K edhe po ja bashkangjes ankeses si prov materjale).

Keshtu qe ky pretendim te pika 5.a) është i pa bazuar sepse sepse është dokumentacioni apo librezja e kamionit me kiper-prov materjale librezja te marrveshtja me kompanin M.SHALA FA. SHPK-folderi nr.15 i ngarkuar me rastin e ofertimit.

-Sipas ktyre pretendimeve AK ka vepru ne kundersizim me vet vehten apo ne kundersizim me vlersimin e pare ku kto pretendime nuk kan qenë per arsye se komisioni ne heren e pare ka qen me korrekt,duke hapur qdo dodokument te ngarkuar e jo duke I fshehur apo anash kalu.E per kto dokumente kam kerku qe ti hapin e jo ti fshehin apo ti anashkalojn,sepse ky gjest është I pa hishem dhe fshehja e dokumenteve qe jan te ngarkuara është krim qe ka pasoja.Prandaj kerkoj nga OSHP-ja qe ti shfletoi qdo document te ngarkuar edhe kto qka I kemi cek si te anashkalune nga AK sepse edhe ne jemi kompani e kti vendi dhe e barabart me kompanit tjera ne aspektin ligjor,I kemi te permbushura te gjitha kriteret, ku te njejtat punë I kryejm nga viti 2018,as nji vrejte nuk e kemi nga as nji AK,as nji denim per mos permbushje te kriterave shtetore nuk e kemi ,jemi taksa pagues I rregullt,prandaj kerkoj drjtsi,transparencë qe kriteret per vlersim mos te anojn nga as njera anë por ne parime te ligjeve te krpp ne Shtetin e Kosoves.

-Vazhdojm me te gjeturat ne mungesë apo mos permbushja e kriterëve nga ana e Grup OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k te propozuar per kontratë.

E GJETURA NR. 1 te Termontimi - Lider Grupi për Menaxherin - kontrata e prezentuar

Dëshmia 2. Për menaxher të projektit; CV, Diploma e skanuar nga origjinali, kontrata e punës ose parakontrata për aktivitetin në fjalë. Letër reference nga punedhënesit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e caktuar. - Vendimi për menaxher të projektit i nënshkruar dhe i vëlosur nga OE.

GRUP OE kanë ofruar si menaxher të projektit z. Afrim Prokshin inxh. i dip. i elektroteknikës, i certifikuar ka referencë, ka përvojë pune etj. Por kontrata e punës e nënshkruar në mes z. Afrim Prokshit dhe kompanisë Termomontimi sh.p.k është **me afat të caktuar** nga data e nënshkrimit: **01.01.2025** dhe data e mbarimit të punës me **31.12.2025** kjo ceket edhe të noteri (prova materiale kontrata e prezentuar-dok. Nr.1) dhe nuk ka asnjë dokument shtesë apo marrveshje me mundësi vazhdimi me inxhinjerin që tregon se për projektin në fjalë që është 2 vjeçar kontrata duhet të jetë deri në përfundim të punimeve, që dmth kontrata duhet të jetë me afat aq sa zgjatë projekti, pra minimum 24 muaj, pra për projektin për të cilin kemi ofertuar **LOT 1 - NDERTIMI I NDRIÇIMIT NE ZALLQ, LOT 2 - NDERTIMI I NDRIÇIMIT NE VRELLE - PROJEKT DY VJEÇAR**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **633-25-7025-5-2-1**.

Në këtë pikë komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të ofertave është dashtë grupin OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k t'a eliminoi nga konkurrenca. Në këtë pikë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit mbanë përgjegjësi ligjore sepse nuk ua ka sqaruar komisionit për vlerësim të ofertave, sepse kur të ofrohet kontrata me inxhinjerin e sidomos Menaxherin me afat të caktuar, nuk është devijim i vogël dhe as nuk mund të përdoret Neni 59 pika 2 dhe as Neni 72 ika 1,2,3, sepse nuk mund të kërkohe sqarime për diçka që shihet dhe dokumentohet se kontrata është me afat më pak se 24 muaj aq sa zgjatë ky projekt. Nuk lejohet të kërkohe sqarime sepse shkelet neni 1 i LPP Qëllimi dhe Neni 7 i LPP-së dëmtim i konkurrencës, dhe as të ofrohet kontratë e Re me vazhdim të validitetit sepse këtë e ka sqaruar Neni 59 pika 5 ku ceket Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, **asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik**, në lidhje me një tender të dorëzuar. Pra nga procedura e hapur kalohet në procedurë të negociuar që është e papranueshme.

E GJETURA NR. 2 te Termontimi - Lider Grupi për Menaxherin e deklaruar - diploma

Tenderi me emrin e lartëcekur është publikuar me 01 gusht 2025, shih Njoftimin dhe dosjen e tenderit

Në B05 Njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit të publikuar me 01 gusht 2025,

Tek Neni III.2.4 Kapaciteti teknik profesional në B05 Njoftimi për kontratë dhe Neni 9.1 & 9.2 Dosje të tenderit, shih:

Kërkesa 2. Menaxheri i projektit të jetë Një Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës ose master drejtimi energjetike me 5 vite përvojë pas diplomimit. Të jetë i certifikuar si auditor i energjise nga universiteti i Prishtines.

Dëshmia e diplomës:

Diploma e ofruar për menaxher e cila gjendet në dosje mbanë datën e diplomimit **14 tetor 2020**, çka nuk e përmbushë kriterin e kërkuar prej min 5 viteve përvojë ashtu si është kërkuar.

Pasi që nenet e LPP-se dhe interpretimet e KRPP-së e sqarojnë se periudha 5 vjeqare përfshinë kohën nga dita e publikimi të B05 Njoftimit për kontratë në 5 vitet e shkuara. Nga data 14 tetor 2020 kur zyrtarishtë ka diplomuar Menaxheri i prezentuar në ofertë deri të publikimi i tenderit me 01 gusht 2025 i bjenë që nuk janë 5 vite përvojë por janë 4 vite e 9 muaj e 16 ditë. (deshmi materiale DIPLOMA- dok. Nr.2).

Grup OE ne konzercium nuk e permbushin edhe ket kriter te menagjeri sipas kerkeses ne DT. Kshtu qe OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k DUHET TE ELIMINOHEN NGA OFERTA.

-E GJETURA NR.3: KERKESA 3:

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te ofrojë dëshmi se ka staf teknik të mjaftueshem dhe atë min. 10punëtorë. Të jenë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë., Dëshmia 3. Lista e punetoreve duhet te dorëzohet e skanuar nga origjinali – e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Kontratat e punetoreve apo parakontratat per aktivitetin ne fjale. Certifikata SSHP

GRUP OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k -nuk kan ofru staf Teknik per arsye se nga e gjith stafi I prezantuar nga dy OE nuk posedon kurfar dokumenti qe tregon nji pergaditje teknike siq jan diplomat e shkollave te mesme kater vjeqare apo tri vjeqar me te cilen personi është teknik,ku prej tyre është vetem nji z.Rrahman Elshani ka ni dip. 3vjeqare elektrikist (por edhe ky është penzioner). DMTH kta OE nuk e permbushin edhe ket krioter sipas kerkeses ne DT. Kshtu qe OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k DUHET TE ELIMINOHEN NGA OFERTA.

-E GJETURA NR.4: KERKESA 4 pika b):

b) Një person i certifikuar për sistemin e integruar të menaxhimit dhe sigurise se trafikut rrugor Per ket pike GRUP OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k -kan ofru z.Fatmir Mecinaj me nji dokument nga nji kompani Ambienti.

Ky dokument apo qertifikat ska te baj fare me sistemet e integruara të menagjimit dhe sigurisë se trafikut per at person,por ka te bej me Menagjimin te siguris se trafikut rrugor te krijuar ne Termomomontim sh.p.k dhe **nuk ka te bej me menagjimet tjera te siguris perveq kompanis se vetë qe asht Termomontimit**, (Prova materiale nr.3 dhe nr.4-ku ku gjindet dok. Dhe perkthimi i saj se qka do te thot). Ak per ket kerkesë nuk është ne dijeni qe shka ka kerku,por edhe OE qe ka ofru nji dokument prej nji kompanie privat ,ajo ska te baj fare me ket kerkesë,sepse ajo ka te bej vetem per strukturen e mbrendshme te kompanis termomontim,lexojeni mirë qka thot. (Prova nr.3 dhe 4) Ndera te institutet shkollore kto sisteme te menagjimit i mesojn per ti realizu direkt ne punë gjat realizimeve te sherbimeve te punimeve ne rrugë (kto sisteme te integruara per

menagjimin e siguris rrugore trajtohen ne sh. e mesme ku jan tri landë qe trajtohen kto sisteme e ne qertifikata apo diploma ska mundsi te shenohen te gjitha veprimtarit sipas landeve) . Arsyja është se kjo qertifikat perveq asaj qe tham ska te bej fare me integrimet por i perket vetem infra struktures se mrendshme te kompanis termomontim.(deshmia nr.3 dhe 4). -sa per njoftim se menagjimin dhe sigurin e trafikut rrugor e kan policia e shtetit,e jo ne me ba interpretime te gabuara dhe te pa sakta ne kerkesa.

-OE nuk e permbushin edhe ket krioter sipas kerkeses ne DT. Kshtu qe OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k - ELIMINOHEN NGA OFERTA.

-E GJETURA NR.5: KERKESA 4 pika c):

c)Dy elektrikist te diplomuar me 5 vite, te certifikuar për punime në lartësi dhe përdorimin e P.M.I për mbrojtjen e rënjes nga lartësia., Dëshmia 4. Të deshmohet me kontratë pune aktive ose parakontrate per aktivitetin ne fjale,

Per ket pike GRUP OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k -kan ofru

Vetem nji elektrikist me diplom tri vjeqare z.Rrahman Elshani I lindur me 16.11.1954 dmth ky as 4vjeqar se ka diplomen (por ktu po ju njoftoi se diplom te shkolles mesme nuk ka 5 vjeqare).

Per elektrikistin e dytë nuk kemi dokumentacin te kta OE GRUP OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k dmth nuk posedojn edhe nji person tjetër qe ka diplom te elektrikistit apo qertifikat sipas kerkeses ne DT perveq Rrahman Elshani,I cili sipas statutit është pensioner (DMTH -ne dokumentacionin e Grup OE nuk posedon as nji diplom tjetër instalime elektrike apo Teknik te elektroteknikes perveq nji e puntorit Z. Rrahman Elshani qe ky puntor tash e ka edhe statutin e penzionerit ,ku ne DT jan kerku dy elektrikista te diplomuar).

Valdet Mulaj është prezentu si elektrikist por nuk ka diplom te elektrikistit apo diplom te elektros e cila është si kerkesë ne dosje te tenderit,por z.Valdet Mulaj ka nji document mbi aftsin profesionale qe ky dokument nuk e plotson kerkesen 4. C)sipas DT.(deshmia nr.5).

DMTH:Grup OE per te njejten kerkesë ku thuhet c)Dy elektrikist te diplomuar,- kta ofrojn dy persona ku njeri ka diplom te elektrikistit z. Rrahmon Elshani, ndersa tjetri ka nji dokument trajnim qe nuk është diplom po as qertifikatë z. Valdet Mulaj (dmth per te njejten kerkesë kan ofru dokumente te ndryshme keshtu qe edhe njera edhe tjetra nuk munden me qen),ku gr. OE per ket ofertë kan ofru vetem nji elektrikist me dokumenta sipas kerkeses qe është z.Rrahmon Elshani,ku edhe ky është pun të kufizuar se është 72 vjeqar, ndersa tjetër elektrikist te diplomuar nuk posedon. Deshmi dy dokumente te ndryshme per te njejten kerkesë-deshmia nr.5 dhe 5,1

Kshtu qe OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k per ket pikë duhet te shpallen te pa pergjegjshem apo te ELIMINOHEN NGA OFERTA.

-E GJETURA NR.6: KERKESA 5 pika :

Ne listen e stafit Teknik jan te vendosur 11 puntor nga 1 deri ne 11, ku prejtyre si teknik vetem nji është me qertifikata per siguri dhe shendet ne punë z.Rrahmon Elshani dmth vetem nji teknik si puntor me qertifikata ndersa tjeret nuk posedojn kurfar deshmie qe jan teknik pa marr parasysh drejtimin.

Edhe ne listen e puntorve te OE Kabashi jan 11 puntor me qertifikata siguri dhe shendet ne punë, por kerkesa ne DT ka qen per Teknik te qertifikuar per siguri dhe shendet ne punë,ndersa OE.Kabash ne listë ka vetem puntor pa as nji diplom apo dokument qe tregon se kta puntor jan Teknik.

Kshtu qe OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k nuk posedojn teknik te qertifikuar vetem nji,dhe ne ket rast Grup OE ne konzercium jan te pa pergjegjshem dhe duhet te **ELIMINOHEN NGA OFERTA.**

Nga AK ne ket rast nga OSHP-ja apo nga komisioni vlersues kerkioi qe ti verifikoi dokumentacionin e Grup OE Termomontim sh.p.k dhe Kabashi Projektim, ndertim sh.p.k ,per arsye se kan pa rregullsi dhe siq po shifet te kta keni ba anashkalime pa i trajtu ne menyre te duhur duke ju dha perparsi dhe duke i shpall te pergjegjshëm dhe nji herit me shperblim te kontrates pa i perfill kriteret dhe kto te meta te tyre ne dokumente dhe njisherit pa e perfill qmimin e ofertes qe e kan me te lartë, e qe ne dosje si kriter per dhenje është qmimi me i ulet ne ofertim..

Prandaj, vendimi i AK është nxjerrë me interpretim te gabuar dhe jo të drejte të kriterëve të përzgjedhjes të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, sepse shpërblen me kontratë Grup OE të pa përgjegjshëm ne kundërshtim me nenin 59 pika 4 e LPP-se dhe 60 pika 1, par 1.1, kurse neve na eliminon pa drejtësisht duke saju dhe komoflu ne kerkesen si kriter ne DT, edhe pse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët në pajtim me kriteret e vlerësimit të parapara nga AK.

AK, me këtë veprim ka bërë shkelje të nenit neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse nuk e trajton ofertën tonë në mënyre të barabar dhe të drejtë, shkel nenin 40.12,sepse me rastin e dorëzimit të dosjes së tenderit oferta jonë është dorëzuar në përputhje të plotë me kërkesën e parapara në NJK, DT. Dhe me çmim me te ulet se sa Grup OE konkurent.

Prandaj është i pa pranueshëm njoftimi për eliminim të kompanisë tonë nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit sepse është i pa arsyeshëm, i pa logjikshëm, i pa drejtë dhe rrjedhimisht është nxjerrë në shkelje të Ligjit.

Për me tepër, AK edhe për kundër ofertës tonë e cila është e përgjegjshme dhe ka çmim me te ulët, e eliminon ofertën tone nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit duke bere shkelje te nenit 59, pika 2 dhe nenit 72, pika 1 e LPPse,nenit 40 te pikes 12 si dhe nenit 38, pika 38.1 e RRPP, sepse, ne raste kur ka pa qartësi apo nevojë për informata shitesë apo te ngjashme dhe, kur është ne pyetje ruajtja e buxhetit duhet te ketë parasysh nenin 1 Qëllimi, Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasitetin dhe, mbi bazën e këtyre neneve dhe për të ruajtur buxhetin, duhet të kërkoj informata sqaruese, sepse neni 59, pika 2, neni 72.1 i LPP-se dhe neni 38, pika 38.1 i RRPP i lejojnë AK që të kërkoj informata sqaruese ne mënyre që mos të dëmtoj buxhetin e AK në vlerë prej 3,280.00€.

- **Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 03.06.2026, si dhe ate te shqyrtimit te kerkeses te**

dates 08.06.2026 ku sipas vendimit per ryshqyrtim qe na është kundërshtu kërkesa shifet qartë se as qe është hap as një dokument i joni nga ana e AK.

AK në kundërshtim të plotë me nenin 56, pika 1, par 1.1 dhe 1.2 dhe nenit 60, pika 1, par 1.1, sepse shpërblen me kontratë **GRUP O.E. "TERMOMONTIMI" SH.P.K. & KABASHI Projektim Ndertim SHPK**, edhe pse është me çmim më të lartë, në kundërshtim të plotë me kriteret e vlerësimit të parapara në njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit dhe informatave sqaruuese, sepse kriter i vlerësimit ka qene **Oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët.**

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, zyrtaret përgjegjës të AK, gjatë vlerësimit, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, kanë bërë një mori shkeljesh të dispozitave Ligjore të LPP-së në vendim, sepse nuk kanë shfrytëzuar dispozitat ligjore që u jep Ligji për të marrë informata dhe sqarime shtese, nuk i kanë shfrytëzuar interpretimet e neneve në ligjin e prokurimit për të nxjerr vendim të drejtë dhe të arsyeshëm, prandaj, për ne është i pa pranueshëm vendimi i AK, sepse jemi palë me interes juridiko material sipas nenin 4.1.26 të LPP-së, jemi të përgjegjshme dhe kemi ofruar çmimin më të ulët në pajtim me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterëve të vlerësimit.

Për më tepër, me këtë vendim, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1, pika 1 dhe 3; nenin 6, pika 1 të LPP-se, sepse, nëse i referohemi Vendimit të Autoritetit kontraktues do të shohim se, çmimi i ofertuar i ofertës së **TONI INGJINJERING sh.p.k GLLOGOC** është **Lot 1 -Ndertimi i Ndrçimit Publik ne Zallq, me vlerë= 49,866.00€**

Lot 2 - Ndertimi i Ndrçimit Publik ne Vrellë- me vlerë= 46,215.00€ dhe, është çmimi më i ulte në dy llotot në raport me çmimin e **GRUP O.E. "TERMOMONTIMI" SH.P.K. & KABASHI Projektim Ndertim SHPK** të propozuar për kontrate në vlerë prej: **Lot 1 -Ndertimi i Ndrçimit Publik ne Zallq, me vlerë= 50,911.00€**

Lot 2 - Ndertimi i Ndrçimit Publik ne Vrellë- me vlerë= 48,450.00€ me që rast, Autoriteti kontraktues me këtë veprim dëmton buxhetin varfër e Republikës së Kosovës dhe të KOMUNËS në veçanti, i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve të Republikës së Kosovës, dem që do të shkaktohet është në shume prej **3,280.00€. Euro.**

Prandaj, pretendimet tona sa i përket dispozitave ligjore të LPP-se, të shkelura nga AK qëndrojnë sepse janë ta bazuara dhe të argumentuara dhe të mbështetura në Ligjin e Prokurimit Publik dhe RRUOPP.

Dhe, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material, jemi të përgjegjshëm kemi ofruar çmimin më të ulët, kemi dëshmi bindëse me prova të argumentuara me rastin e dorëzimit të dosjes së tenderit se jemi në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e AK dhe, mbi bazën e këtyre fakteve, kërkojmë nga **Organi shqyrtues i prokurimit**, që kërkesën-Ankesën për ri-shqyrtim ta trajtoj me pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-se, ta trajtoj në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e parapara në njoftim për kontratë dhe dosjes së tenderit **SI DHE TË KETË NË KONSIDERATË VLEREN PËR PARA, SEPSE KY ËSHTË EDHE QËLLIMI I LPP-së.**

Përfundim:

Kërkojmë nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit**, që:

- ✓ Të aprovoj Ankesen për rishqyrtim të bazuar;
- ✓ Të anuloj vendimin për dhënie të kontratës;
- ✓ Te kthej rastin në rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat dhe RRPP.
- ✓ Te na shpërblej me kontratë sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmim me të lirë.

Mbetemi me shpresë se Kërkesa-Ankesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me nderime,

Malush Krasniqi

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jonë është dëmtuar për shpenzimet e bera me rastin e përgaditjes dhe dorzimit të ofertave siq janë kërkuar, shpenzimet e sigurisë së tenderit, përgaditjes së kërkesës për rishqyrtim. Përgaditjes së Ankesës në OSHP, dëmtimi i reputacionit ndaj partnerëve dhe fitimet e pritura.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.
- e) **Provë: 01.1, 0.1; 01.b dhe 01.2-** Sqarimet lidhur me dokumente të fshehura në fjalë - formulari i tenderit.;
- f) **Provë: 1.1; 1.2; 1.3-** të Gjeturat në mangësi apo jo të rregullta sipas dosjes së tenderit të Group OE
- g) **Provë:** Informatat 1.8 dhe 1.9 -raportet e AK. në kundërshtim me vet vëhten.